<a href="#">Shtojca 11. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)</a>	
<a href="#">Shtojca 12. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër</a>	
<a href="#">Shtojca 13. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)</a>	

---

## Shtojca 1.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontrates;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

---

6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	



**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik )

**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**

\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					

---

<b>TVSH (%)</b>	
<b>Çmimi total me TVSH:</b>	
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> <b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

---

### Shtojca 3.

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik* ]

[ *Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve* ]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [ *Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor* ]

Në emër të: [ *Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar* ]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [ *lloji i procedurës* ]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ *objekti* ]

Publikimi ( *nëse zbatohet* ): Buletini i Njoftimeve Publike [ *Data* ] [ *Numri* ] / Nr. Referencës në faqen e APP-së

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [ *emri i autoritetit kontraktor* ] vlerën e siguar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [ *njoftimin e kontratës* ].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

---

#### Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

---

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Specifikime teknike
-----	-----------------------	---------------------

1.	Leter A3 (500 fije) [80gsm, 297mm x 420mm]	<p>Letrat të jenë origjinale dhe të cilësisë së parë. Të jetë CIE bardhësi <math>169\pm 3</math>, dimensionet: 297x420mm. Pesha e një fije të jetë 80 gr/m<sup>2</sup> dhe një rizme (500 fije x A4), Lagështira: 3.5-4.5 %. Trashësia: 104-112µm. Drita : <math>\geq 94\%</math>. Shkelqimi : 101-114%, Të mos jete e ricikluar, Letra të ketë mbështjellje kundër lagështirës. Letra të mos bllokohet makinën fotokopjuese apo printerin, fax-in. Të qëndroje e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit. Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit. Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët. Të plotësojë standartet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë.</p>
2.	Leter A4 (500 fije) [80gsm, 210mm x 297mm]	<p>Letrat të jenë origjinale dhe të cilësisë së parë. Të jetë CIE bardhësi <math>169\pm 3</math>, dimensionet: 297x210mm. Pesha e një fije të jetë 80 gr/m<sup>2</sup> dhe një rizme (500 fije x A4), Lagështira: 3.5-4.5 %. Trashësia: 104-112µm. Drita : <math>\geq 94\%</math>. Shkelqimi : 101-114%, Të mos jete e ricikluar, Letra të ketë mbështjellje kundër lagështirës. Letra të mos bllokohet makinën fotokopjuese apo printerin, fax-in. Të qëndroje e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit. Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit. Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët. Të plotësojë standartet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë.</p>
3.	CD	<p>Këto CD duhet të mbajnë deri në 800 Mb ose jo më pak se 90 minuta regjistrim. Shpejtësia e shkrimit të diskut deri në 40x. Secili disk te kete kutine (kapakun) e tij. Te kene nje shtrese mbrojtese ekstra kundra gervishtjeve.</p>
4.	Dosje me llastik (thellësi 6cm)	<p>Kjo dosje të jetë prej kartoni te presuar dhe te plastifikuar dhe shërben për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha dokumentat tuaja të rëndësishme. Ajo mbyllet me ndihmën e një llastiku, në mënyrë që të ruajë sa më mirë materialet në brendësi si dhe për t'u lëvizur lehtësisht. Me llastik të gjerë. Përmasat <math>32\pm 0.5\text{cm} \times 24\pm 0.5\text{cm} \times 6\pm 0.5\text{cm}</math>. Me trashësi të kartonit <math>\geq 600\text{gm}^2</math>.</p>
5.	Dosje arkive me mekanizëm	<p>Kjo dosje me mekanizëm shërben për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha dokumentet duke i kapur me mekanizëm. Ajo duhet të ketë një mekanizëm metalik, i cili i mban dokumentat të mbërthyer me anë të dy shufrave dopjo në të cilat vendosen letrat A4 pasi janë hapur vrimat përkatëse me hapëse vrimash dopjo ose qeset mbajtëse përkatëse. Gjithashtu, duhet të ketë një etiketë për identifikim të lehtë të kontekstit të dokumenteve përbërëse. Materiali te jete polipropilen me shkelqim. Te jete lehtesisht elastike. Të mbajë jo më pak se 600 fletë me gramaturë 80gm<sup>2</sup>.</p>

6.	Dosje Arkive me buton	Dosje me buton me thellësi $15\pm 0.5\text{cm}$ , material polipropileni. Kjo dosje me buton shërben për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha dokumentet tuaja të rëndësishme. Gjithashtu, ajo ka një etiketë për identifikim të lehtë të kontekstit të dokumenteve përbërëse. Përmasat $240\pm 5\text{mm} \times 350\pm 5\text{mm}$ . Mundesisht te kete nje vrime e cila lejon terheqjen e saj sa me lehte nga arkiva.
7.	Qese plastike A4	Pako me 100 qese plastike prej materiali polipropilen, transparente dhe me madhësi A4, me spesor jo më pak se 100 mikron. Këto qese mund të përdoren me të gjitha llojet e lidhësve të unazave si një mënyrë për të mbrojtur dhe renditur dokumentet. Çdo qese të ketë kapacitet mbajtës jo më pak se 40 fletë A4 $80\text{gm}^2$ secila.
8.	Kapak plastik transparent A4	Kapak PVC transparent A4 me trashësi jo më pak se 200 mikron. Paketimi në pako 100 copë.
9.	Kapak kartoni A4	Kapak kartoni A4 me masë $270\text{-}280\text{gm}^2$ me ngjyra të ndryshme. Paketimi në pako deri në 100 copë.
10.	Shina plastike A4 për lidhje dokumentash	Shina plastike A4 për lidhje dokumentash 12-16
11.	Makinë kapse Aktesh (Stapler)	Makina për kapse aktesh (Stapler), të jetë metalike dhe me material çelik i pandryshkshëm ose i kromuar në formë pince (dore). Makina të jetë përshtatshme për të kapur deri në jo më pak se 45 fletë të gramaturës $80\text{ gr/m}^2$ . Të përdoret me tela/kapëse 24/6, 26/6, 26/8 dhe 24/8.
12.	Makinë kapse Aktesh e Madhe (23/6-23/24)	Makinë kapëse aktesh prej materiali metalik. Makina të jetë përshtatshme për të kapur deri në jo më pak se 200 fletë të gramaturës $80\text{ gr/m}^2$ . Gjithashtu ajo duhet të kapi dhe me pak fleta në varësi të përdorimit duke ndërruar numrin e telave. Te kete depozite per te vendosur telat. Çdo informacion shtesë për numrin e telave që përdoren në varësi të fletave duhet të jenë të shpjeguara dhe në trup të produktit. Telat te jene nga 23/6 deri 23/24.
13.	Tela/kapëse 24/6	Kapëset/tela të jenë të dizajnuara me material të cilësisë së lartë, të galvanizuar dhe të jenë parashikuar për të shpuar pastër përmes fletëve të shumta të letrës pa u këputur ose shqyer letrën. Të jenë prej metali të kromuar ose të pandryshkshëm. Te kapi deri ne jo me pak se 30 flete te gramatures $80\text{gr/m}^2$ . Paketimi 1000 copë.
14.	Tela/kapëse 23/10	Kapëset/tela të jenë të dizajnuara me material të cilësisë së lartë dhe të galvanizuar, të jenë parashikuar për të shpuar pastër përmes fletëve të shumta të letrës pa u këputur ose shqyer letrën. Te kapi deri ne jo me pak se 70 flete te gramatures $80\text{gr/m}^2$ . Paketimi 1000 copë.
15.	Tela/kapëse 23/13	Kapëset/tela të jenë të dizajnuara me material të cilësisë së lartë dhe të jenë parashikuar për të shpuar pastër përmes fletëve të shumta të letrës pa u këputur ose shqyer letrën. Paketimi jo më pak se 1000 copë.

16.	Tela/kapëse 23/20	Kapëset/tela të jenë të dizajnuara me material të cilësisë së lartë dhe të jenë parashikuar për të shpuar pastër përmes fletëve të shumta të letrës pa u këputur ose shqyer letrën. Paketimi jo më pak se 1000 copë.
17.	Mprehëse lapsash	Mprehës lapsash me dy vrima dhe me depozitë për ashklat e mprehura, po ashtu edhe me gome. Për lapsa deri në Ø11 mm dhe kënd mprehës te ndryshem. Thikat e mprehjes të jenë metalike të kromuara ose metal i pandryshkshëm.
18.	Kapse me vesh 25mm	Ndërtimi i produktit të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Ngjyra e zezë. Paketimi jo më pak se 12 copë.
19.	Kapse me vesh 32 mm	Ndërtimi i produktit të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Ngjyra e zezë. Paketimi jo më pak se 12 copë.
20.	Kapse me vesh mm 41mm	Ndërtimi i produktit të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Ngjyra e zezë. Paketimi jo më pak se 12 copë.
21.	Kapse me vesh 63 mm	Ndërtimi i produktit të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Material metalik ngjyra gri metalizato.
22.	Korrektor stilolaps	Korrektor në formë stilolapsi që shërben për korrigjimin e gabimeve të bëra gjatë shkrimit. Siguron mbulim të mirë dhe thahet shpejt duke lënë një shtresë të butë mbi të cilën mund të shkruhet sërish.
23.	Kapëse "U" 28mm	Kapëse dokumentash, 28 mm. Të jetë ideale për të kapur letra apo dokumente të ndryshme në zyrë, shkollë etj. Të jetë e ndërtuar me material çeliku të qëndrueshëm. Paketimi në pako me jo më pak se 100 copë kapëse.
24.	Stilolaps i zakonshëm me majë sferike blu	Stilolaps i tipit ballpoint me majë 0.7mm-1mm. Të mos krijojë ngecje apo rrjedhje boje gjatë shkrimit.
25.	Stilolaps i zakonshëm me majë sferike i kuq	Stilolaps i tipit ballpoint me majë 0.7mm-1mm. Të mos krijojë ngecje apo rrjedhje boje gjatë shkrimit.
26.	Tampon vule blu	Tampon vule i mesëm me kuti metalike. Përmasat 80mm ± 10mm x 150mm ± 10mm.
27.	Bojë vule blu	Bojë për të gjitha llojet e vulave. Bojë e pastër mjedisore dhe shumë rezistente. Jo toksike. Paketimi në shishe plastike jo më pak se 20ml.
28.	Goma për fshirje lapsi	Gomë universale për fshirje lapsi dhe boje. Të jetë e bërë nga materiali gome e bute ( jo PVC ), e pershtatshme për të fshire dhe njollat me të theksuara të lapsit dhe bojës. Nuk duhet të lerë shenja dhe grimca në fletë pas përdorimit. Pa ftalate dhe lateks.



29.	Lapsa HB	Lapsi prej grafiti të jetë i prodhuar nga materiale sintetike, që do të thotë se nuk lëshon cifla në rast se thyhet, si dhe të jetë rezistent ndaj shtypjes dhe përdorimit. Shkalla e grafitit të jetë HB. Lapsat te jene jo toksik.
30.	Evidenciator (highlighter)	Evidenciator (highlighter). Evidenciatori të ketë një majë të petëzuar e cila ndihmon për nënvijëzime ose evidentime. Të ketë ngjyrë të hapur (jo të errët dhe të mundësojë shikimin lirshëm të shkrimit në dokumente pasi vijëzohet mbi të), e cila thahet menjëherë dhe nuk është toksike. Maja e vijëzimit të jetë minimumi 5mm.
31.	Stick ngjitës	Ngjitësi nuk duhet të jetë toksik dhe nuk duhet të përmbajë acid duke shmangur kështu dëmtimin e materialeve në të cilat përdoret. Material PVP. Paketimi jo më pak se 35g në formë cilindri roller.
32.	Mbajtëse kancelarie	Mbajtëse kancelarie me set i cili perbehet minimumi nga 12 produkte. Në këtë set duhet të përfshihen minimalisht këto produkte: mbajtësja e rrotullueshme e kancelarive, laps, stilolaps, gërshërë, vizore, prefëse lapsi, kapse letrash etj. Mbajtësja të jetë prej materiali plastik. Preferohet ngjyrë e errët.
33.	Mbajtëse dokumentash metalike me 3 kate	Mbajtëse dokumentash metalike 3 kate, ngjyrë e zezë, me përmasa 36±1cm x 28±1cm x 30±1cm. Ajo shërben për të vendosur dokumentat e përdorimit të përditshëm dhe është e përshtatshme për zyra. Të jetë tërësisht metalike dhe shumë e qëndrueshme.
34.	Heqëse telash stapler	Heqëse teli ne forme pinçe e përbërë nga material metalik. Të heqë të gjitha llojet e telave standarte. Të jetë i përshtatshëm për përdorim zyre.
35.	Blllok letrash me ngjitje	Bllloqe me ngjitje 75mm±1 mm x 75mm±1 mm me 50 fletë me ngjyra të ndryshme. Letrat ngjitëse shërbejnë për të nxjerrë në pah mesazhet e rëndësishme dhe ngjiten edhe mbi sipërfaqe të vështira. Ato mund të përdoren për të shënuar lajmërime,shënime etj.
36.	Makine llogaritese	Makinë llogaritëse tavoline me jo më pak se 12 shifra të shfaqura në ekran.Trup me formë elegante me hark. Ekran i madh me pjerrësi të rregullueshme. Burim energjie me bateri dhe diellore. Me opsion Tax+ dhe Tax, po ashtu edhe me opsion per kembimin valutor. Zgjedhje rrumbullakimi dhe presje dhjetore. Fikje automatike.
37.	Vizore 50 cm	Vizore me gjatësi 40-50 cm prej materiali metalik dhe rezistente që nuk thyhet. Te kete kellefin e vet.

38.	Bllok shënimesh (Note book)	Bllok shënimesh me kapak të fortë (hard cover). Minimumi me 100 fletë. Në format shkrimi me ndarje horizontale të barabarta.
39.	Liber Protokolli (400 fletë) [35cmx25cm]	Do të prodhohen sipas modeleve që do të vihen në dizpozicion nga autoriteti kontraktor.
40.	Dosje kartoni me mbishkrim (fashikuj)	Dosjet duhet të jenë format A4, me mbishkrim
41.	Zarfa A4	500 copë kutia
42.	Zarfa A5	500 copë kutia
43.	Pen drive 16 GB, shpejtësia 3.0	16 GB, shpejtësia 3.0
44.	Pen drive 32 GB, shpejtësia 3.0	32 GB, shpejtësia 3.0
45.	Pen drive 64 GB, shpejtësia 3.0	64 GB, shpejtësia 3.0
46.	Pen drive 128 GB, shpejtësia 3.0	128 GB, shpejtësia 3.0

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

Sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor , nga nënshkrimi i kontratës deri me 31.12.2022.

Nr	Përshkrimi i mallrave	Njesia	Sasia	Cmimi/njesi	Shuma
1	Leter A3 (500 fije) [80gsm, 297mm x 420mm]	pako	200		
2	Leter A4 (500 fije) [80gsm, 210mm x 297mm]	pako	1500		
3	CD	cope	500		
4	Dosje me llastik (thellësi 6cm)	cope	350		
5	Dosje arkive me mekanizëm	cope	330		
6	Dosje Arkive me buton	cope	300		
7	Qese plastike A4	pako	200		
8	Kapak plastik transparent A4	cope	300		
9	Kapak kartoni A4	cope	293		
10	Shina plastike A4 për lidhje dokumentash	cope	300		
11	Makinë kapse Aktesh (Stapler)	cope	50		
12	Makinë kapse Aktesh e Madhe (23/6-23/24)	cope	20		
13	Tela/kapëse 24/6	pako	1000		
14	Tela/kapëse 23/10	pako	500		
15	Tela/kapëse 23/13	pako	500		
16	Tela/kapëse 23/20	pako	200		
17	Mprehëse lapsash	cope	200		
18	Kapse me vesh 25mm	pako	100		
19	Kapse me vesh 32 mm	pako	100		

20	Kapse me vesh mm 41mm	pako	100		
21	Kapse me vesh 63 mm	pako	100		
22	Korrektor stilolaps	cope	500		
23	Kapëse "U" 28mm	pako	100		
24	Stilolaps i zakonshëm me majë sferike blu	cope	3000		
25	Stilolaps i zakonshëm me majë sferike i kuq	cope	300		
26	Tampon vule blu	cope	15		
27	Bojë vule blu	cope	20		
28	Goma për fshirje lapsi	cope	200		
29	Lapsa HB	cope	1000		
30	Evidenciator (highlighter) ( pako me 4 ngjyra te ndryshme)	pako	190		
31	Stick ngjitës	cope	500		
32	Mbajtëse kancelarie	cope	50		
33	Mbajtëse dokumentash metalike me 3 kate	cope	50		
34	Heqëse telash stapler	cope	100		
35	Bllok letrash me ngjitje	cope	1000		
36	Makine llogaritese	cope	50		
37	Vizore 50 cm	cope	200		
38	Bllok shënimesh (Note book)	cope	300		
39	Liber Protokolli (400 fletë) [35cmx25cm]	cope	50		
40	Dosje kartoni me mbishkrim (fashikuj)	cope	5000		
41	Zarfa A4 500 cope kutia	kuti	30		
42	Zarfa A5 500 cope kutia	kuti	30		
43	Pen drive 16 GB, shpejtësia 3.0	cope	25		
44	Pen drive 32 GB, shpejtësia 3.0	cope	25		
45	Pen drive 64 GB, shpejtësia 3.0	cope	25		
46	Pen drive 128 GB, shpejtësia 3.0	cope	20		

TOTALI

0

---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

#### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

---

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, ne masen 2 % te fondit limit prej 61.666.6 (gjashtedhete e nje mije e gjashteqind e gjashtedhete e gjashte presje gjashte )lek pa tvsh, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

---

Fusha e veprimtarisë së operatorit ekonomik ofertues duhet të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të çertifikuar nga organet tatimore. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**2.2.2** Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2021 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete. (Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara shpalljes fitues, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore).

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara ose vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

## **2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

---

**2.3.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit, nga jo më pak se një 1(një) kampion për disa nga mallrat objekt prokurimi, të përcaktuara me nr. Rendor: **1,2,4,11,32,33,36,38,43**, sipas listës së publikuar nga autoriteti kontraktor në Shtojcën nr. 6.

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.
- Mostrat duhet të paraqiten për artikujt objekt i këtij prokurimi
- Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.

**Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim.**

- Operatori ekonomik duhet të deklarojë se mallrat që do të dorëzoje do të jenë të njëjtë me mostrat e paraqitura ditën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të cilës merr përsipër të kryerje shërbimin e transportit të të gjithë artikujve të kërkuar në adresën e autoritetit kontraktor.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**



## Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I, Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### A. Pjesa I:

#### Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----     
Numri NIPT/et:	-----  -
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----  ----
Përfaqësuesi (emri):	-----  
Telefoni:	-----  ---
E-mail:	-----  -----

---

## B: DEKLARATË

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik**

(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

<b>Emri i nënkontraktorit të propozuar</b>	<b>NIPT –i</b>	<b>Përqindja e nënkontraktimit</b>	<b>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar</b>

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

<b>Emri (at) e subjekteve</b>	<b>NIPT-i</b>	<b>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</b>	<b>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</b>

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:

<p>aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP- .</p>	<p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.	
---	--

## B: DEKLARATA

### Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklaratë;	Po [ ]
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po [ ]
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po [ ]
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi	Po [ ]

<p>për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;</p>	
<p>5. Për efekt të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:</p> <p>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti Kontraktor;</p> <p>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .</p>	<p><b>Po [ ]</b></p>
<p>6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;</p>	<p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p>
<p>7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).</p>	<p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p>

<p>8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</p> <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p>	<p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p>
<p>9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</p>	<p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p>
<p>10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.</p>	<p><b>Po [ ] Jo [ ]</b></p>

**C: DEKLARATA**



## Mbi Konfliktin e Interesit

### Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

